



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË

Nr 4280 Prot

Tiranë, më 18.9 2015

URDHËR

Nr. 402 datë 18.09.2015

PËR
MIRATIMIN E FORMULARËVE TIP TË RAPORTIT MJEKËSOR PËR
VEPRIMTARITË PËR ARMËT

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 4 të Ligjit Nr.10107, datë 30/03/2009 “Për Kujdesin Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë” dhe në zbatim të Udhëzimit të Përbashkët të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Ministrisë së Shëndetësisë nr.88, datë 10.03.2015 “Për llojet e vizitave dhe përmbajtjen e raportit mjekësor për veprimtaritë me armët”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e formularit tip “Certifikatë anamneze” dhe “Certifikatë mjekësore” për veprimtari të lejuara me armët, sipas shtojcës 1 dhe 2;
2. Përdorimi i formularëve tip “Certifikatë anamneze” dhe “Certifikatë mjekësore” për veprimtari të lejuara me armët, të bëhet në përputhje me Udhëzimin e Përbashkët të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Ministrisë së Shëndetësisë nr.88, datë 10.03.2015 “Për llojet e vizitave dhe përmbajtjen e raportit mjekësor për veprimtaritë me armët” dhe aktet rregullatore në fuqi për sistemin e referimit dhe aplikimin e tarifave për shërbimet mjekësore;
3. Ngarkohen ofruesit e kujdesit shëndetësor parësor dhe kujdesit mjekësor të specializuar në sektorin publik të kujdesit shëndetësor për përdorimin e formularëve tip sipas pikës 1, me qëllim zbatimin e Udhëzimit të Përbashkët të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Ministrisë së Shëndetësisë nr.88, datë 10.03.2015;

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.



KOMISIONI MJEKËSOR
QENDRA SHËNDETËSORE _____

ÇERTIFIKATË MJEKËSORE
për veprimtari të lejuara me armët

Fotografi 35x42
mm e firmosur
nga kërkuesi dhe e
kontrolluar nga
kryetari i
komisionit

Bazuar ne çertifikatën e anamnezës nr _____, të lëshuar nga mjeku i
familjes i Qendres Shëndetësore nr. _____ dhe plotësuar nga mjeket
sipas specialiteteve.
Bashkia _____

Vërtetohet që Z./Znj _____
i/e lindur në _____ më dt. _____
dokumenti i njohjes _____ nr _____
i lëshuar nga _____ më dt. _____
paraqet (përshkruaj sëmundjet, gjymtimet dhe nivelin e tyre, të cilat ndikojnë në aftësinë për
të përdorur armë)

si rrjedhim gjykohet që _____ Është i përshtatshëm _____ për veprimtari të lejuara me armët
Nuk është i përshtatshëm

Lëshuar në _____, datë _____.

KOMISIONI

KRYETAR

ANËTAR

ANËTAR

(Drejtori i QSH)

(Mjeku i familjes)

(Mjek familje)

Shënim: Në rast të QSH me numër të mjekëve të familjes më pak se 3, Komisioni mund të ketë në përbërje
mjekë të familjes të QSH të tjera, në të njëjtën Bashki.
Çertifikata hartohet në dy kopje, një kopje i jepet të interesuarit dhe tjetra mbahet në institucionin që e lëshon

